



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:255415
Datë: 30.12.2024
Numri i dokumentit: 06668874

CA.nr.13208/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët, Hidajete Gashi Alaj, kryetare e kolegjit, Hunaida Pasuli dhe Nehat Idrizi, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësve-propozuesve L.R., e lindur D. dhe M. D., që të dy më parë nga P., tani me vendbanim në A., R. e S., të cilët sipas autorizimit i përfaqëson av. Y.G.-K. nga fshati B., Komuna I., kundër të paditurve B. (M.) D. nga fshati V., Komuna P., tani me vendbanim në K., R. e S. dhe M. (Novo) D., me vendbanim në fshatin B., Komuna P., të cilët i përfaqëson përfaqësuesi i përkohshëm av. B. C. nga Peja, për shkak të propozimit për caktimin e masës së sigurisë, duke vendosur sipas ankesës së paditësit - propozuesit të masës së sigurimit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.3683/23, të datës 07.10.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 19.12.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e paditësve - propozuesve të masës së sigurisë L.R., e lindur D. dhe M. D., që të dy më parë nga P., tani me vendbanim në A., R. e S. dhe Serbisë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.3683/23, i datës 07.10.2024, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e ankimuar C.nr.3683/23, të datës 07.10.2024, ka vendosur si vijon:

“REFUZOHET propozimi i propozuesve L.R., e lindur D. dhe M. D., që të dy më parë nga P., tani me vendbanim në A., R. e S., për caktimin e masës së sigurisë, me të cilin kanë kërkuar që kundër propozuesve B. (M.) D. nga fshati V., Komuna P., tani me vendbanim në K., R. e S. dhe M. (N.) D., me vendbanim në fshatin B., Komuna P., TË IU NDALOHET çfarëdo ndërrimi në

kadastër apo tjetërsim te ngastrave kadastrale nr.00555-9, me 1/16 pjesë, e që ka sipërfaqen e tërësishme 975 m², ngastrës nr.00555-11 me 5/16 pjesë, që ka sipërfaqen e tërësishme prej 300 m², dhe ngastrës 00555-12 me 5/16 pjesë që ka sipërfaqen e tërësishme 4951 m², ZK Pejë, në tersi si i pa bazuar .”

Kundër këtij aktvendimi brenda afatit ligjor paditësit - propozuesit e masës së sigurimit, përmes të autorizuarës së tyre, kanë paraqitur ankesë, kundër aktvendimi të gjykatës së shkallës së parë me të cilin është refuzuar propozimi i propozuesve duke mos treguar për shkaqet për të cilat kanë paraqitur ankesën, me propozimin që Gjykata e Apelit që ta ndryshoj Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Pejë C.nr.3683/23 të dt.07.10.2024, ashtu që ta Aprovoj ankesën e palës propozuese, duke caktuar masën e sigurisë, me të cilin vendim kundër propozuesve të iu ndalohet çfarëdo ndërrimi apo tjetërsimi në ngastrat kadastrale nr.00555-9, ngastrën nr. 00555- 11 dhe ngastrën 00555-12 në ZK Pejë, apo lëndën ta kthej në rishqyrtim.

Kundërshtarët e sigurimit, nuk kanë parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit e Kosovës, si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e paditësve-propozuesve të masës së sigurimit, është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit - propozuesit e masës së sigurimit, përmes të autorizuarës së tyre, me datë 22.11.2023, në gjykatën e shkallës së parë kanë parashtruar padi, kundër të paditurve për anulim kontrate, ndërsa përmes parashtrësës së datës 09.02.2024 kanë paraqitur propozim për caktimin e masës së sigurisë.

Duke vepruar sipas propozimit të propozuesve, gjykata e shkallës së parë ka mbajtur seancën dëgjimore dhe pas administrimit të provave, ka ardhur në përfundim se propozimi i propozuesve për caktimin e masës së sigurisë, është i pa bazuar, për çka edhe ka vendosur që ta refuzon, duke vendosur decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar C.nr.3683/23, të datës 07.10.2024.

Gjykata shkallës së parë, në arsyetim të aktvendimit të atakuar ka theksuar se, gjykata me qëllim të krijimit të kushteve procedurale e me propozimin e të autorizuarës të palës paditëse - propozuesve të sigurimit në mungesë të adresës së vendbanimit përkatësisht vendqëndrimin të tanishëm të të paditurve- kundërshtarëve të sigurimit, të njëjtëve në mbështetje të dispozitës 79, par.3, pika a) dhe b) të LPK - së, e më qëllim të mbrojtjes të interesave të tyre në procedurë ka caktuar përfaqësuesin e përkohshëm nga radha e anëtarëve të Odës së Avokatëve të Kosovës, B.C., avokat në P..

Më tutje ka theksuar se gjykata shqyrtoi me kujdes padinë me propozimin për masën e sigurimit dhe pas analizimit të lëndës ka ardhur në përfundim se propozimi i propozuesve për caktimin

masës së sigurisë, është i pa bazuar. Me nenin 297 të LPK - së, në mënyrë decisive ceket se "Masa e sigurimit mund të caktohet në qoftë se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të drejtës subjektive të tij , dhe në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së kësillë pala kundërshtare do të mund të pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës , sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet , me fshehjen e saj , me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër , me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave , ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit " . Po ashtu me nenin 300 të LPK - së është paraparë " se për sigurimin e kërkesës së drejtuar kah sendi i caktuar apo kah një pjesë e tij mund të caktohen disa lloje të masave të sigurimit " , ndërsa me nenin 304.3 të LPK- së , është përcaktuar mes tjerash se " propozuesi në propozimin e tij duhet t'i tregojë edhe faktet mbi të cilat mbështetet kërkesa e tij, si dhe të propozohen mjetet provuese me të cilat mund të provohen pretendimet e parashtruara në propozim" , si dhe që këto "mjete provuese t'ia bashkëngjisë propozimit".

Gjykata duke vlerësuar propozimin e propozuesit të sigurimit dhe deklarimeve të dhëna ne seancën e datës 04.10.2024 , i njëjti nuk ka arritur ti bëj të besueshëm faktin se ekziston fillimisht e drejta subjektive e tij, pasi që të njëjtit nuk kanë bashkëngjitur asnjë provë të vetme që të argumentoj raportin familjar me tani të ndjerën J. (J.) D., e cila ka lidhur kontratë mbi mbajtjen e përrjetshme me këtu të paditurit - kundërshtaret e sigurimit, gjithashtu duke pasur parasysh se kushti i dytë i përcaktuar me dispozitën e latë cekur është qe duhet të ekzistoj rreziku se pa caktimin e një mase të tillë do të i vështiroset apo edhe pamundësohet realizimi i kërkesës nëse nuk caktohet një masë e tillë , pra as kushti i dytë nuk është plotësuar e duke pasur parasysh se me nenin 297 të LPK - së këto dy kushte duhen të plotësohen në mënyrë kumulative për çka asnjëri nga këto dy kushte nuk janë plotësuar. Andaj nga të gjitha këto ka vendosur që ta refuzon si të pabazuar propozimin e propozuesve për caktimin e masës së sigurisë.

Gjykata e Apelit e pranon vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar më ankesë nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) të LPK, për të cilat Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkeljet e tjera të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Në këtë drejtim, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, sipas dispozitës së nenit 297, paragrafi 1 pika a) dhe b) dhe 297 paragrafi 2 të LPK, përcaktohet në mënyrë të qartë se "*Masa e sigurimit mund të caktohet në qoftë se plotësohen në mënyrë kumulative tri kushte dhe atë: besueshmëria ekzistimit të kërkesës apo të së drejtës subjektive, ekzistimi i rrezikut se pa caktimin e masës së sigurimit do të pamundësohet apo vështirësohet dukshëm realizimi i kërkesës dhe deponimi i garancionit*". Në çdo rast kur nuk plotësohet ndonjëri nga kushtet e sipër theksuara atëherë gjykata nuk mund të vendosë për aprovimin e kërkesës për sigurimin e kërkesëpadisë. Në këtë rast Gjykata e Apelit e pranon në tërësi përfundimin e gjykatës së shkallës së parë se në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet për caktimin e masës së sigurimit, për shkak se propozuesit e masës së sigurimit nuk e kanë bërë në masë të mjaftueshme të besueshme të drejtën e tyre subjektive në raport me rastin në fjalë, po ashtu nuk e kanë provuar me prova konkrete materiale

ekzistimin e rrezikut se pa caktimin e një mase të tillë paditësit do t'iu shkaktohet dëm i pariparueshëm.

Në rastin konkret Gjykata e Apelit e pranon përfundimin e gjykatës së shkallës së parë për mos caktimin e masës së sigurimit, për shkak se gjykata e shkallës së parë e ka arsyetuar në masë të mjaftueshme përfundimin e saj për refuzimin e caktimit të masës së sigurimit. Kjo për faktin se nga provat në shkresat e lëndës ka rezultuar se propozuesit e masës së sigurimit nuk e kanë bërë mjaftueshëm të besueshme ekzistimin e kërkesës respektivisht të drejtën e tyre subjektive, gjithashtu nuk e kanë argumentuar faktin se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së tillë do të pamundësohet apo vështirësohet realizimi i kërkesës, për shkak të mundësisë së bartjes, ndërrimit apo tjetërsimit të pronës nga ana e kundërshtarëve të sigurimit, po ashtu nuk kanë ofruar asnjë provë materiale se të paditurit – kundërshtarët e masës kanë filluar apo dëshirojnë të tjetërsojnë apo ndryshojnë gjendjen faktike në paluajtshmërinë kontestuese.

Gjykata e Apelit vlerëson se, në kontekstin e rrethanave të paraqitura në këtë çështje juridike kontestuese e që i referohen pretendimeve të propozuesve të sigurimit lidhur me rrezikun e mundshëm, sidomos me bartjen e paluajtshmërisë apo ndryshimin e gjendjes ekzistuese ose ngarkimi i saj me ndonjë të drejtë tjetër sendore dhe propozuesit do t'i pamundësohet realizimi i të drejtës për vërtetimin faktit, pa e prejudikuar përfundimin meritore të çështjes, në këtë fazë të procedurës konsiderohet i drejtë qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë se caktimi i masës së sigurimit në këtë fazë të procedurës nuk është i arsyeshëm dhe i bazuar.

Gjykata e Apelit i ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera ankimore të paraqitura në ankesë, por ka gjetur se janë të pathemelta dhe se nuk ndikojnë që gjykata të merre një vendim ndryshe. Por, në rastin konkret gjykata ankimore ka vlerësuar se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paraqitura me ankesë për shkak se gjykata e shkallës së parë përfundimin e saj e ka arsyetuar në masë të mjaftueshme sa i përket rrethanave që kanë ndikuar për refuzimin e kërkesës për caktimin e masës së sigurisë.

Përfundimisht, Gjykata e Apelit i ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë, por nuk ka gjetur se ekziston ndonjë shkelje e cila do të ndikonte që vendimi të kualifikohet si i tillë për çka çështja pastaj do të duhej të kthehej në rishqyrtim.

Nga të cekurat më lartë, e në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 208 dhe 209 pika (b) e LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CA.nr.13208/2024, datë 19.12.2024

Kryetare e kolegjit
Hidajete Gashi Alaj, d.v.